



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2195/2 prot.,

Datë 11.09.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A. SH. Engineering” SHPK në procedurën e prokurimit “E kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)” me Nr. REF-77835-08-18-2023, me objekt: “Mbikqyrja e punimeve të ndërtimit me objekt Rindërtimi i kopsht çerdhe në fshatin Golem”, me fond limit 1,547,849.1 (një milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë pikë një) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

**Ankimues:**

“A. SH. Engineering” SHPK me NIPT L31617003F dhe adresë Rruga “Grigor Gjirokastriti”, ish Fusha e Aviacionit, Ndërtesa 12. Kati i Parë, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Kavajë me adresë Bulevardi "Josif Budo"

Në datën 08.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3406 dhe me nr. 2195/2023 prot., datë 08.09.2023 e operatorit ekonomik “A. SH. Engineering” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “A. SH. Engineering” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “A. SH. Engineering” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- 1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.*
- 2. Referuar pikës 2/c të kriterëve të veçanta të kualifikimit, operatori ekonomik nuk ka paraqitur Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5. Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 11.09.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anila Malaj**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**